



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 136, Datë 07.07.2025

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ENERGOVIA.ALBANIA” SH.P.K. PËR LICENCIM
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.07.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/10 prot., datë 01.07.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij Aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

Fillimi i Procedurës së Licencimit

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 113, datë 03.06.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 04.06.2025 dhe 05.06.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.06.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

Kërkesa për Dokumentacionin Plotësues

- ERE, me shkresën nr. 1693/7 prot., datë 05.06.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Duke qenë se shkresa e mësipërme është kthyer mbrapsht nga

shërbimi postar, ERE i ka dërguar shoqërisë me e-mail një kopje të skanuar të shkresës, në datën 11.06.2025.

Dorëzimi dhe Vlerësimi i Dokumentacionit Plotësues

- Në datën 20.06.2025, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të munguar, ndërsa për dëshminë e penaltetit për administratorin, shoqëria ka bërë me dije se do ta depozitojë në ERE sapo të pajiset me të dhe të përkthehet. Sa referuar në e-mail është depozituar dhe fizikisht në protokollin e ERE-s.

Shtyrja e Afatit të Vendimmarrjes

- Referuar nenit 14, pika 3 të Rregullores, bordi i ERE-s mund të zgjatë afatin e vendimmarrjes deri në 30 ditë, kur dokumentacioni nuk është i plotë.
- Për sa parashikuar nga Rregullorja dhe në kuptim të sa bërë me dije nga shoqëria, që do të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore të administratorit sapo të pajiset me të, për t'i dhënë mundësi shoqërisë që të depozitojë këtë dokument, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë brenda 20 (njëzet) ditëve vërtetimin për gjendjen gjyqësore të administratorit të saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir AHMETI